



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Trajnimi i trajnuesve

Janar 2023

Aktivitetet e përgjithshme

Vizitë studimore e përkthyesve dhe interpretëve në Parlamentin Evropian dhe Komisionin Evropian



Nga data 23-26 janar 2023 në mbështetje të Programit të BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë – EUKOJUST, përkthyes dhe interpretë nga Akademia e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës vizituan shërbimet evropiane të përkthimit në Parlamentin Evropian dhe Komisionin Evropian në Bruksel.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vëzhgimi praktik i

metodave të punës së shërbimeve të përkthimit në Parlamentin Evropian dhe Komisionin Evropian dhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira në këtë fushë.

Gjatë kësaj vizite përkthyesit dhe interpretët realizuan takime me delegacionin për marrëdhënie me Bosnje Hercegovinën dhe Kosovën, Drejtorin e Përgjithshëm për çështje të përkthimit pranë Parlamentit Evropian (DG TRAD), Drejtorin e Përgjithshëm për çështje të interpretimit pranë Parlamentit Evropian (DG LINC), si dhe shefen e njësisë për koordinim dhe çështje institucionale.

Në këto takime u shkëmbyen përvojat dhe njëkohësisht u diskutuan sfidat dhe vështirësitë e përkthyesve dhe interpretëve gjatë punës.



Ceremonia e çertifikimit të pjesëmarrësve në kursin HELP



Më 24 janar 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, organizuan ceremoninë e çertifikimit të pjesëmarrësve të cilët kanë përfunduar kursin me temë: “Luftimi i Dhunës kundër grave, dhunës në familje” përmes platformës së mësimin në distancë HELP.

Ky kurs kishte për qëllim të trajtojë në mënyrë interaktive konceptet kryesore, kornizën ligjore ndërkombëtare dhe evropiane dhe praktikën gjyqësore në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së grave dhe vajzave nga dhuna, duke i kushtuar vëmendje të veçantë Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e

Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (e ashtuquajtura Konventa e Stambollit).

Kursi përmbante tetë module, të cilat përfshinin aspekte të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të cilat kishin limite kohore të përcaktuara në pajtueshmëri me materialet e përcaktuara në secilën prej tyre.

Njëherit Drejtori ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu dhe shefi i zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë z. Frank Power falënderuan të gjithë profesionistët ligjor që ishin pjesë e këtij kursi gjatë vitit 2022, i cili çdo vit e më shumë po ndiqet nga grupe të ndryshme të profesionistëve ligjor.

Ceremonia e çertifikimit u organizua me pjesëmarrës nga nivele të ndryshme si: Gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë të qendrave për punë sociale, bashkëpunëtorë profesional, zyrtar ligjorë.

Takim me kryetar dhe kryeprokuror për rishikimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët që priten të emërohen (gjenerata e X) 2023/2024



Më 27 janar 2023, në kuadër të procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe përcaktimit të Programit trajnues fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët që priten të dekretohen së shpejti është realizuar takimi konsultativ me kryetar dhe kryeprokuror si dhe me anëtarët e Këshillit Programor.

Qëllimi i këtij takimi ishte rishikimi i përmbajtës aktuale të programit trajnues duke përfshirë strukturën dhe metodologjinë e trajnimeve fillestare si dhe përshtatja me nevojat për

gjeneratën e X të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.

Gjatë takimit të gjithë pjesëmarrësit pa përjashtim konfirmuan nevojën e trajnimit fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj dhe gjithashtu ri konfirmuan përmbajtjen e programit pa ndryshime.

Nga ana e Akademisë u vu në pah vendimi i KGJK-së për ngarkesën me lëndë të gjyqtarëve të rinj si një nga faktorët që e dëmton vijueshmërinë në trajnime të gjyqtarëve konform programit.

Pjesëmarrës të kësaj punëtorie ishin: anëtarët e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë, Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore, Kryetarë të Gjykatave dhe Kryetari i Komisionit për trajnime në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.



Trjnimi për stafin e AD-së: Ndjeshmëria gjinore dhe Kodi i Sjelljes në vendin e punës



Me 31 janar 2023, në mbështetje të projektit EKOJUST është realizuar trajnimi për stafin e Akademisë së Drejtësisë me temë: “Ndjeshmëria gjinore dhe Kodi i sjelljes në vendin e punës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve të stafit për ndjeshmërinë gjinore si dhe për sjelljet në vendin e punës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Në pjesën e parë të trajnimit u diskutua për ndjeshmërinë gjinore, për kuptimin gjinor, kuptimin e gjinisë biologjike, rolet, stereotipet gjinore si dhe për barazinë gjinore në vendin e punës. Me rastin e trajnimit u diskutua edhe për Ligjin e Kosovës për barazi gjinore, Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi si dhe për standardet e BE-së sa i përket barazisë gjinore si dhe ndjeshmërisë gjinore.

Gjatë trajnimit u përdoren edhe raste hipotetike

për ndjeshmërinë gjinore dhe stereotipet që ndikojnë në barazinë gjinore dhe në vendin e punës.

Në pjesën e dytë të trajnimit u diskutua për Kodin e Sjelljes, përkatësisht për elementet kryesore të tij si vlerat e punëdhënësve, sjellja e punonjësve, praktikrat e brendshme dhe praktikrat e jashtme duke e elaboruar edhe me raste hipotetike. Në vazhdim u trajtua edhe Ligji për Zyrtarët publik me theks te ligjshmëria, transparenca, paañësia dhe pavarësia profesionale, jo diskriminimi, shmangia e konfliktit të interesit si dhe për parimin e mundësive të barabarta. Pavarësisht parimeve mbi të cilat bazohet ky ligj u vunë në pah edhe vështirësitë ligjore në zbatim të këtij ligji meqenëse nuk janë aktet tjera përcjellëse të rregulluara.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit patën mundësinë e diskutimit dhe parashtrimit të pyetjeve për temat që u trajtuan duke marrë edhe përgjigjet për situatat konkrete.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 22 pjesëmarrës nga stafi i Akademisë së Drejtësisë të cilët në fund morën certifikatat për pjesëmarrje në trajnimin përkatës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar, grupi I-gjenerata (IX)



Që nga fillimi (korrik) i zbatimit të trajnimit fillestar për 48 gjyqtarë të kësaj gjenerate, për shkak të numrit relativisht të madh ka qenë i ndarë për dy grupe. Grupi i I përbëhej prej 29 gjyqtarëve, 2 prej tyre nga minoriteti serb të cilët për shkak të rrethanave politike nga muaji nëntor janë dorëhequr nga pozita e gjyqtarit, 1 në pushim të lehonisë, kanë vazhduar të mungojnë në trajnimin fillestar edhe për gjatë muajit janar.

Gjatë muajit janar, për grupin e I të gjyqtarëve të sapo emëruar, gjenerata e IX janë realizuar gjithsej 32 sesione trajnimi nga modulet: E drejta civile, administrative dhe ekonomike si dhe Shkathhtësitë personale dhe ndër personale.

Në kuadër të modulit: E drejta civile, administrative dhe ekonomike janë realizuar sesione 4 sesione trajnuese nga nën moduli “Procedura jokontestimore” ç ‘rast janë trajtuar: rregullimi i marrëdhënieve pasurore juridike dhe shfrytëzimi i sendit të përbashkët, hartimi i vendimit në procedurën jokontestimore dhe mjetet juridike, dispozitat e përgjithshme të ligjit të procedurës jokontestimore dhe rregullimi i marrëdhënieve familjare.

Nga nën moduli “E drejta familjare” janë realizuar 6 sesione të cilat kanë përfshijë aspekte të rëndësishme nga e drejta familjare si kuptimi i familjes, burimi i të drejtës familjare, kuptimi dhe llojet e gjinisë, e drejta martesore, zgjidhja e martesës procedura e shkurorëzimit detyrimi për ushqimi dhe e drejta e prindërore, format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror, kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë dhe atësisë, marrëdhëniet pasurore në mes të bashkëshortëve dhe dhuna në familje.

Nga nën moduli “E drejta e punës” janë realizuar 5 sesione me ç ‘rast janë trajtuar: themelimi i marrëdhënies së punës (Ligji i punës dhe Ligji i zyrtarëve publik), kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të punës, kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit për zyrtar publik, mbrojta në punë dhe kompensimi i dëmit shkaktuar në punë.

Nga nën moduli: “Procedura kontestimore-pjesa e parë” janë realizuar 2 sesione të cilat kanë përfshirë raste nga praktika gjyqësore.

Në kuadër të nën modulit: “E drejta e detyrimeve” është realizuar 1 sesion nga i cili është trajtuar: kontrata mbi mbajtjen e përyetshme, kontrata mbi qiranë dhe kontrata për shitje.

Në kuadër të nën modulit: “Procedura kontestimore-pjesa e dytë” janë realizuar 6 sesione dhe janë trajtuar: ndërprerja dhe posedimi i procedurës, sigurimi i kërkesë padisë, dëshmitarët ekspertët dhe palët, procedurat e posaçme kontestimore, simulimi i seancës përgatitore dhe asaj të shqyrtimit gjyqësor .

Nga moduli: Shkathësitë personale dhe ndërpersonale, janë realizuar 4 sesione për “Arsyetimin e vendimeve në lëmine penale” dhe 4 sesione për Arsyetimin e vendimeve në lëmine civile. Në këto sesione janë trajtuar parimet e shkrimit ligjor, shkrimi ligjor, interpretimi dhe arsyetimi ligjor dhe metodologjia e formulës IRAC, struktura dhe përmbajtja e aktgjyqimeve si në penale ashtu

edhe në civile.

Metodologjia e zhvillimit të trajnimit është zbatuar me raste praktike duke trajtuar shembuj dhe me anë të metodës së bashkëbisedimit.



Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar, grupi II-gjenerata (IX)



Gjatë muajit janar, për grupin e dytë i cili përfshinë 18 gjyqtarë janë realizuar gjithsejtë 24 sesione trajnimi nga modulet: Kodi penal i Kosovës, Kodi i procedurës penale, Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale si dhe Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese.

Në kuadër të modulit Kodi Penal i Kosovës janë realizuar 2 sesione trajnuese për “Përgjegjësinë e personave juridik” me theks te Përgjegjësia penale e personave juridik dhe kuptimi i personit juridik dhe bazat dhe kufiri i përgjegjësisë së personave juridik.

Nga moduli Kodi i Procedurës Penale janë realizuar 3 sesione trajnuese nga nën moduli “Provat në procedurën penale” me ç’rast janë trajtuar: Kuptimi dhe llojet e provave në procedurën penale, provat sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe ekspertimi dhe masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit dhe llojet e tyre si prova. Në vijim të këtij moduli, 1 sesion trajnues për Rolin e gjyqtarit në procedurën paraprake në caktimin dhe vazhdimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale, 1 sesion nga nën moduli “Prokurori i shtetit, mbrojtësi i dëmtuari dhe i pandehuri si palë në procedurën penale, 3 sesione trajnuese për shqyrtimin gjyqësor me theks te Rrjedha e shqyrtimit gjyqësor, paraqitja e provave dhe fjala përfundimtare, si dhe procedura e marrjes dhe

shpalljes së aktgjykimit. Gjithashtu në kuadër të këtij moduli edhe 2 sesione trajnuese për Procedurat e veçanta sipas KPPK-së me ç’rast janë trajtuar Procedurat ndaj personave të cilët kanë kryer vepra penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës dhe procedurat penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore dhe paraburgimi

Në kuadër të modulit Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale janë realizuar 4 sesione trajnuese nga nën moduli Arsyetimi i vendimeve në lëmin penale me theks te Shkrimi ligjor, parimet e shkrimit ligjor, shkrimi ligjor dhe metodologjia e përdorimit të formulës IRAC, arsyetimi ligjor dhe metodologjia e hartimit të aktgjykimit penal. Në vijim të këtij moduli edhe 1 sesion trajnues nga nën moduli “Ngritja e shkathtësive gjyqësore dhe menaxhimi i stresit” me theks te Mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së punës dhe jetës.

Nga moduli Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese janë realizuar 6 sesione trajnuese nga nën moduli “Kodi i drejtësisë për të mitur” me ç’rast janë trajtuar aspekte të rëndësishme materiale dhe procedurale duke filluar nga hyrje në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, parimet udhëzuese, përkufizimet, masat dhe dënimet ndaj të miturve dhe zgjedhja e tyre, shqiptimi i masave dhe dënimeve madhorëve për veprat penale të kryera si të mitur, efekti i dënimit në masën edukuese, masat e diversitetit dhe ndërmjetësimi, masat edukuese dhe dënimet.

Është vazhduar në vijim me dispozitat e përgjithshme që e karakterizojnë procedurën penale ndaj të miturit, parimet e procedurës dhe kompetencat e gjykatave, subjektet e procedurës, shërbimi i sprovues dhe organi i kujdestarisë dhe fazat e ndryshme të procedurës, kush e zhvillon (prokurori,

gjyqtari për të mitur, trupat gjykues), procedura përgatitore, arresti, ndalimi policor, paraburgimi dhe shqyrtimi gjyqësor dhe vendimet e gjykatës dhe vendimet gjyqësore, mjetet juridike, gjykimi i madhorëve për vepra penale të kryera ndaj fëmijëve dhe mbrojtja e fëmijëve viktime apo dëshmitarë.

Në vijim të këtij moduli edhe 1 sesion trajnues nga nën moduli për procedurat alternative me theks te lirimi nga dënimi si dhe 4 ditë për



zhvillimin e shkathtësive gjyqësore përmes simulimit të gjyqimit të një rasti hipotetik.



Trajnimi fillestarë për prokurorët e sapo emëruar, gjenerata (IX)



Gjatë muajit janar, për prokurorët e sapo emëruar që janë 6 gjithsejtë janë realizuar 16 sesione trajnimi teorik nga 6 nën modulet që janë pjesë e modulit Kodi i procedurës penale si dhe 10 ditë të trajnimit praktik në prokuroritë përkatëse.

Nga nën moduli “ Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale ” janë realizuar 4 sesione trajnuese, me ç’rast janë trajtuar marrja në pyetje dhe e deklaratave e dëshmitarëve para ngritjes së aktakuzës, dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues, i dëmtuari, marrja në pyetje e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor dhe leximi i procesverbaleve.

Nga nën moduli “ I pandehuri në procedurën penale ” janë realizuar 3 sesione trajnuese me theks te I pandehuri si subjekt i procedurës penale dhe deklarimi i të pandehurit si provë, të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë procedurës penale, pozita e të pandehurit pas ngritjes së aktakuzës dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri gjatë procedurës së shkurtës dhe procedura për ndihmë juridike dhe i pandehuri gjatë procedurës së shkurtër dhe procedura për ndihmë juridike ndërkombëtare.

Nga nën moduli “ Procesverbalet ” janë realizuar 3 sesione trajnuese me ç’rast janë trajtuar Procesverbalet, krijimi dhe mbajtja e procesverbaleve, regjistrimi i seancave me incizim audio dhe incizim audio dhe video dhe shikimi i procesverbalit dhe shkresave të lëndës.

Nga nën moduli “ Administrimi i procedurës penale ” janë realizuar 3 sesione trajnuese, temat e trajtuara në këto sesione janë; parashtrësat, afatet si dhe marrja dhe komunikimi i vendimeve, marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe ekzekutimi i



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimet për Risitë e Kodit të Procedurës Penale

Me 13-14 janar si dhe 27-28 janar 2023 në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, janë realizuar dy aktivitete trajnuese me temë: “Risitë e Kodit të Procedurës Penale” Aktiviteti i parë është realizuar për regjionin e Prizrenit, ndërkaq aktiviteti i dytë për regjionin e Prishtinës.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte njoftimi i gjyqtarëve dhe prokurorive duke përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor lidhur me Risitë e Kodit të Procedurës Penale, të cilat kanë tendencë për ndryshime të nevojshme dhe efektive.

Trajnimet u orientuan në trajtimin dhe shpjegimin sa i përket Mbrojtës së detyruar, mbrojtësit me shpenzime publike dhe kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës.

Më tej është vazhduar me hedhjen e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar aktvendimin, masat e veçanta hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake, mundësia hetuese e veçantë, hetimi (afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve).

Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatave dhe prokurorive.

Në këtë trajnim u trajtua edhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit.

Ndër të tjera u shtjellua edhe Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor duke u vazhduar me standardin e rishikimit të ankesave shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe procedura penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike

Pjesëmarrës në trajnimin dedikuar regjionit të Prizrenit ishin: 2 gjyqtarë, 5 prokurorë, 10 avokatë, 2 mbrojtës i viktimave si dhe 9 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional, zyrtarë ligjor dhe zyrtarë tjerë administrativ nga gjykata dhe prokuroria në Prizren.

Pjesëmarrës në trajnimin dedikuar regjionit të Prishtinës ishin 3 gjyqtarë të nivelit themelor, 16 prokurorë (5 nga niveli themelor, 10 nga PRSK si dhe 1 nga zyra e Prokurorit të Shtetit) dhe si dhe 14 avokat dhe 1 mbrojtës i viktimave.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimit për trajnues

Trajnimi i trajnuesve për ndërmjetësimin-sesioni IV



Me 28-31 janar 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së, ka realizuar sesionin e IV të Trajnimit të Trajnuesve për Ndërmjetësim.

Gjatë këtij sesioni trajnues, 15 ndërmjetësuesit e përzgjedhur si pjesë e grupit të trajnuesve kanë përgatitur planet e tyre rreth trajnimeve bazike për Ndërmjetësim, të cilat do zhvillohen gjatë javës së parë të muajit shkurt, me

përfitues studentë dhe profesionist të tjerë ligjorë.



Gjatë tre ditëve të trajnimit grupi prej 15 trajnuesve është ndarë në 3 grupe punuese dhe kanë rishikuar mënyrën e arsimimit për të rritur, dallimet e trajnimit të ndërmjetësuesve të rinjë dhe atyre me përvojë, deklaratat hyrëse, deklaratat e palëve dhe format e negociimit.

Gjithashtu gjatë këtij trajnimi kanë bërë përgatitjet paraprake për trajnimet bazike që do të realizohen në vijim në tri regjione të ndryshme (Prishtinë, Prizren, Mitrovicë).

Ky aktivitet është mentoruar nga 3 ekspertët e programit FMCS, z. Peter Swanson, znj. Emily Rife dhe z. Dave Moora.


Përfitues të Trajnimit janë 15 ndërmjetësuesit e përzgjedhur në Programin e Trajnimit të Trajnuesve brenda Akademisë së Drejtësisë.

Vijueshmëria në trajnim në PTF përmes grafikoneve




Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve


Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Institucioneve - Janar 2023



Numri i pjesëmarrjes dhe trajnimeve të realizuara sipas fushës- Janar 2023




Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara-Janar 2023




Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve


Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Institucioneve - Janar 2023





Numri i pjesëmarrjes dhe trajnimeve të realizuara sipas fushës- Janar 2023




Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara-Janar 2023



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Vijueshmëria e stafit të AD-së



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660